



# SMS P

- **Mos e lini makinën në hapësirë që nuk është e shënuar!** Makina juaj mund të ngritët dhe të merret nga shërbimi me merimangë e ju do të duhet të bartni shpenzimet për parkim të gabuar në rast se makina është parkuar në hapësirë që nuk është e shënuar.
- **Kini kujdes për orarin e punës së parkingut!** Një pjesë e parkingjeve janë me orar të kufizuar të punës, gjegjësisht në një periudhë të caktuar të ditës ato janë të dedikuara ekskluzivisht për banorët e ndërtesave lokale. Kjo kohë është e shënuar në tabelat e parkingut.
- **Pritni të pranoni përgjigje me SMS!** Pasi të dërgoni SMS për të paguar parkingun, pritni të pranoni informatë kthyesë për të vërtetuar nëse parkimi ka filluar. Nëse mesazhi nuk dërgohet në mënyrën e duhur, vlerësohet se makina është parkuar në mënyrë të parregullt. Nëse ka ndonjë problem me sistemin për pagesë, drejtohuni të nëpunësit të cilët patrollojnë në parkingje ose lajmërohuni në numrin e telefonit të shënuar në tabelën e parkingut.

Për më tepër informacione për të drejtat tuaja si konsumator mund të drejtoheni te Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë  
 telefoni: (02) 3 179 592  
 ueb faqja: <http://www.opm.org.mk>  
 e-mail: [sovetuvanja@opm.org.mk](mailto:sovetuvanja@opm.org.mk)

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE TË QYTETIT SHKUP ME PROGRAMIN E VET E MBËSHTET MBROJTJEN E KONSUMATORËVE**

Qyteti Shkup



**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE**

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE TË QYTETIT SHKUP**  
 Bul. Ilinden nr. 82 - Shkup



Qyteti Shkup

Qyteti Shkup



**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE**

**PARKIMI ZONAL**

**PARKIMI I QYTETIT SHKUP**

**PARKIMI KOMUNA QENDËR**

Parkim zonal është marrje me qira e vend parkimit të shënuar për makinën tuaj. Parkim zonal në qytetin e Shkupit ofrojnë dy ndërmarrje publike: Parkim i Qytetit Shkup, dhe Parkimet Komuna Qendër. Pagesa bëhet me SMS, gjegjësisht me telefon celular dhe automate apostafat të shënuara ku mund të blihet biletë. Hapësira e parkimit është e shënuar me tabelë në të cilën janë shënuar informacionet e nevojshme për konsumatorin, që të mund të blejë biletë. Pagesa e parkimit zonal me anë të telefonit celular mund të bëhet vetëm nëpërmjet operatorit mobil nacional në RM.

## Parkimi i Qytetit Shkup

Mënyra e pagesës së parkimit me telefon celular:

SMS në numrin e telefonit 144 144, nga të gjithë operatorët mobilë.

Teksti i mesazhit: "ZONA\_REGJISTRIMI"

Psh: **C81 SK1234AB**

- **ZONA** – Zona në të cilën e parkoni makinën (A, B, C ose D). Menjëherë, pas shkronjës e shënoni numrin rendor të zonës, bashkë pa hapësirë
- **VEND I ZBRAZËT**
- **REGJISTRIMI** – Regjistrimi i makinës suaj (pranohen targa të regjistrimit me 3 dhe 4 numra). Ndërmjet karaktereve të regjistrimit nuk lihet vend i zbrazët

Nga momenti i dërgimit të mesazhit, ju ngarkojnë me pagesë të një shume të caktuar (që varet nga zona) në fillim të çdo gjysmë ore. Ngarkesa për pagesë të parkimit ndërpritet me dërgimin e mesazhit "S" në alfabetin latin.

| Zona | Çmimi (1 orë) | Maksimum orë    |
|------|---------------|-----------------|
| A    | 45 denarë     | 2               |
| B    | 35 denarë     | 4               |
| C    | 25 denarë     | Nuk ka kufizime |
| D    | 25 denarë     | Nuk ka kufizime |

## Parkimi Komuna Qendër

Mënyra e pagesës së parkimit me telefon celular:

SMS në numrin e telefonit 144 144, nga të gjithë operatorët mobilë.

Teksti i mesazhit: "ZONA\_REGJISTRIMI\_KOHA"

Psh: **1 SK1234AB 1**

- **ZONA** – Zona në të cilën e parkoni makinën (0, 01, 1 ose 2)
- **VEND I ZBRAZËT**
- **REGJISTRIMI** – Regjistrimi i makinës suaj (pranohen targa të regjistrimit me 3 dhe 4 numra). Ndërmjet karaktereve të regjistrimit nuk lihet vend i zbrazët
- **VEND I ZBRAZËT**
- **KOHA** – Numri i orëve që i blini, gjegjësisht sa kohë do të qëndroni në vendin e parkimit

Numrin e orëve për parkim e caktoni vetë, dhe kjo kohë mund të vazhdohet sipas nevojave tuaja.

| Zona   | Çmimi (1 orë) | Maksimum orë |
|--------|---------------|--------------|
| 0 Utra | 100 denarë    | 1 orë        |
| 01     | 50 denarë     | 2 orë        |
| 1      | 40 denarë     | 2 orë        |
| 2      | 30 denarë     | 3 orë        |

Orari i punës së vend-parkimeve të hapura me të cilat ekonomizon NP Parkimi Komuna Qendër është:

- çdo ditë prej ora 08:00 deri 22:00
- të shtunën prej ora 08:00 deri 22:00



## Kini kujdes!!!

Kur të lini makinën tuaj në vendin e parkimit duhet të keni kujdes për këto gjëra:

- Mos lini gjëra të vlershme në makinë! Ndërmarrjet publike nuk e garantojnë sigurinë e makinës suaj gjatë kohës së parkimit.
- Mos zini hapësirë më të madhe se hapësira e paraparë! Parkimi i parregullt, zaptimi i hapësirës më të madhe se është e nevojshme, i jep të drejtë ndërmarrjes publike të zhvendosë makinën tuaj nga ai vend ose të vendosë bllokues.